

STATUTI

I SHOQERISE " BUJARI KONSTRUKSION " SH.P.K

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 9901 date dt.14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe te gjitha legjislacionit Shqiptar ne fuqi, me vullnetin e lire, ortaket e shoqerise,

- **ERMAND BUJARI** i biri i GJERGJIT, lindur ne LAC me 02/03/1981, banues ne TIRANE, me leternjoftimi I10302193C DHE
- Lulzim Bujari i i biri i GJERGJIT, lindur ne Lac me 14/05/1987 , banues ne TIRANE, me leternjoftimi I70514077V
-

sot me daten 10/03/2025 harton dhe miraton Statutin e Shoqerise Tregtare " **BUJARI KONSTRUKSION " sh.p.k.**


KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME.

NENI 1

Forma, Emertimi dhe Selia e Shoqerise.

- Shoqeria eshte person Juridik privat dhe nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, veprimtaria e te cilit do te rregullohet nepermjet ketij statuti dhe aktit te themelimit.
- Shoqeria do te paraqitet me emrin " **BUJARI KONSTRUKSION " sh.p.k.** Ky emertim eshte i vetmi i shoqerise dhe perdoret ne te gjitha regjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me te tretet apo shtetin dhe eshte i vlefshem si jashte dhe brenda vendit.
- Selia e shoqerise do te jete ne Zona kadastrale nr 1768 , lloji i pasurise Are, nr i pasurise 4/15/1,4/16/1,4/17/1, fshati Gjorem, Lac
- Transferimi i selise se shoqerise, ne nje vend tjeter, behet me Vendim te Ortakeve.
- Shoqeria ka te drejte te operoje me zyra, filale, dege apo agjensi ne te gjitha Territorin e Shqiperise apo dhe jashte shtetit.
- Zyrat filialet, deget apo agjensite, krijohen me Vendim te Ortakeve te shoqerise, te cilet organizojne punen dhe emrojne organet drejtuese dhe perfaqesuesit e tyre ligjor.
- Shoqeria ka vulen dhe logon e saj indentifikuese, ne formen dhe me ekstremitetet e caktuara nga ortaket.
- Akt themelimi dhe statute jane ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe kane karakter te deyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga Legjislacioni Shqiptar.



NENI 2

Regjistrimi juridik i shoqerise.

2.1 Shoqeria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

2.2. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil, në fuqi.

2.3 Me vendim të ortakeve, Shoqeria mund të ndryshojë regjistrimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi, si dhe në përputhje të plote me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë dhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqeria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë së shoqerisë.

3.1. Shoqeria është themeluar për të vepruar me këto objekt veprimtarie:

Fraksionim inertesh, magazinim dhe prodhim të materialeve të ndërtimit kryesisht inerte (Cakull, Rere, Granit etj), prodhim dhe shitje betoni. Aktivitet në fushën e ndërtimit si: Ndërtim rrugësh, ujësjellës, kanalizime të të gjitha kategorive. Ndërtim i digave, tuneleve dhe veprave të artit, ura dhe hidrocentrale të të gjitha kategorive. Ndërtim dhe restaurim të objekteve civile - industriale - turistike, porte, aeroporte, gazsjellës etj. Gjithashtu shoqëria do të ketë si objekt veprimtarie: prodhimin dhe tregtimin e materialeve të ndërtimit, inerte, blloqe tubacione, soleta të parafabrikuara etj. Ndërtim për nënstacione, kabina të transformatoreve, ndërtim impianti për energji elektrike; Ndërtim, rikonstruksione apo ristrukturime dhe mirëmbajtje për objektet e prodhimit, transformimit, transmetimit, matjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në rrjetat e Tensionit të Lartë, të mesëm dhe të ulët. Përfshirë Hidrocentrale, Termocentrale, Parqe Eolike, Impiante Voltaike, Nënstacione, Linja Transmetimi, transformimi dhe shpërndarje të energjisë elektrike. Montimi dhe mirëmbajtje, ose ristrukturimi i një sistemi të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimes, të impianteve pneumatik si dhe të linjave telefonike të jashme dhe impiante telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësise së tyre. Shitje-Blerje të autoveturave dhe mjeteve të rëndësishme kamiona, Import-eksport dhe tregti me shumicë e të makinerive për ndërtim. Punime ndërtimi të çfaredolloj dhe rikonstruksione, projektimin dhe zbatimin, pa u kufizuar i veprave urbane, civile, industriale, arkitekturore, rrugore dhe hekurudhore, urave dhe veprave të artit, si dhe punime inxhinierike topografike dhe hidrologjike, inxhinierike të impianteve të prodhimit dhe transmetimit të energjisë etj. Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërve, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, Transport kombëtar dhe ndërkombëtar për mallra të ndryshme dhe/ose udhëtarë për të tretë dhe me qira. Transport me mjete jashtë norme. Gjenerimin

dhe nxjerjen e materialeve nga burimet e veta apo nga te tretet. Huadhenie te makinerive. Zhvendosje te dherave dhe shembje. Nivelim te truallit dhe bonifikime. Punime hidraulike, ngritjen e kolonave. Konsulence Inxhinierike. Kryerje procesesh nentokesore ne puset e naftes. Projektimin, zhvillimin, kerkimin dhe instalimin e impianteve te prodhimit, te transportit, shperndarjes e te perdorimit te energjise elektrike dhe te energjise alternative. Gjithashtu mund te fitoje kontrata koncesioni te puneve publike dhe private. Nder te tjera mund te marre interesa, kuota, aksione dhe pjesemarrje te shoqerive te tjera, te ndermarrjeve dhe industrive qe kane qellime te njejta apo qe kane lidhje ose gjithsesi mund te ndihmojne ne arritjen e qellimit te objektit te shoqerise. Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut, sinjalistikes rrugore jo ndricuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

3.2

Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

NENI 4

Kohe zgjatja e shoqerise

3.1 Kohezgjatja e shoqerise "**BUJARI KONSTRUKSION**" sh.p.k, eshte e pa kufizuar dhe fillon ne momentin e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

3.2 Ky afat mund te ndryshohet ne cdo kohe me vendim te ortakeve.

3.3 Shoqeria mund te priset ne cdo moment me vendim te ortakeve.

KAPITULLI II


KAPITALI THEMELTAR

NENI 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000,00 leke (njqind mije) leke dhe perbehet nga numeri i pjeseve 2 dhe me vlere nominale dhe me perqindje si me poshte

- **ERMAND BUJARI** vlere nominale 50.000 leke / perqindje 50%.



LULZIM BUJARI vlere nominale 50.000 leke / perqindje 50%.

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuota e Pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij teresisht, apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejta ortakut duhet ta ushtroje brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortakut qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emerine e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te afruara ortakut tjeter te shoqerise.

NENI 7

Kapitali i shoqerise perbehet, nga kapitali fillestar plus shtesen e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te palujtshme etj, te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 8

Kuotat e kapitalit jane te pasqyruara dhe te regjistruara ne librat e llogarise te shoqerise.

NENI 9

Heqja dore e ortakut nga bashkepunimi, nuk e cliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton dhe te drejatat qe jane krijuar para largimit te tij.

NENI 10

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve ne proporcion me perqindjen e kapitalit te investuar, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar ne ligj .

NENI 11

Shoqeria tragtare "**BUJARI KONSTRUKSION**" " sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, material ose jo material, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurive se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise Shoqeria tregtare "**BUJARI KONSTRUKSION**" " sh.p.k. gezon te drejta sikunder cdo person tjeter juridik, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 12



Shoqeria tragtere " **BUJARI KONSTRUKSION** " " sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejttat e detyrimit vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqerise, mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket kane patur para se ajo te krijohet .

KAPITULLI I III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Kopetencat e ortakeve

13.1 Kane te drejte te administrojne aktivitetin e shoqerie, konform objektit te veprimtarise se saj, duke perfshire edhe veprimtarine prodhuese e tregtuese qe Shoqeria mund te kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane te drejte te marrin dijeni per rezultatet ekonomiko financiare ne cdo faze te aktivitetit te saj. Kane te drejte te marrin pjese vete ose me ane te perfaqesueseve ne kete aktivitet.

13.2 Kane te drejte te terheqin te gjitha dokumentat kryesore te shoqerise per tre vjetet e fundit.

13.3 Kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe mund te shesin pjesen e kapitalit te tyre ne perputhje me kushtet qe i lejon statuti dhe ligji.

13.4 Ortaket ne perputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin ne fuqi kane, te drejte qe ne te njejten kohe te jene ortake edhe ne shoqeri te tjera.

13.5 Ortaket rezervojne te gjitha te drejttat sipas ligjit Tregtar.

NENI 14

Shoqeria do te drejtohet nga administrator i saj qe zgjidhet nga mbledhja e ortakeve sipas rregullave te percaktura ne ligjin per shoqerite tregtare.

NENI 15

Administrimi i shoqerise

15.1 Administratori i shoqerise emerohet nga ortaket e shoqerise i cili do jete njeri nga Ortaket **ERMAND BUJARI** me nr ID I10302193C nga data 10 /03/2025 me afat 5vjecar deri me date 09/03/2030 me te drejte riemerimi .

15.2 Administratori ka te gjitha te drejttat dhe fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim qe te arrije objektivat e saj, pervec atyre qe ligji ua jep ortakeve.

15.3 Administratori perfaqeson shoqerine ne mardhenie me te tretet si dhe para organeve te administrates dhe atyre gjyqesore.

15.4. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statudit apo per deme te kryera gjate administrimit. Ortaket kane te drejte te ngrejne padi ndaj administratorit.

15.5 Administratori emrohet dhe shkarkohet me vendim te ortakeve.

15.6 Shoqeria administratohet te pakten 1(nje) dhe maksimumi 3(tre) administrator, te cilet qendrojne ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen per nje periudhe maksimale prej 5 vjetesh.

15.7. Cdo administrator do te kete te drejte per rimbushimin e shpenzimeve te bera prej tij per llogari te shoqerise .


15.8 Kur administratori i shoqerise rezulton i sukseshem ne punen e tij dhe ne rezultatin financiar te kompanise atehere ortakët vendosin lidhur me shperblimin qe do ti jepet atij, ne fund te vitit financiare .

NENI 16

Detyrat e Administratorit .

Administratori jo ortak pervec detyrave qe i caktojne ortakët e shoqerise ka dhe keto detyra dhe te drejta.

- Te mire administroje pasurine e shoqerise.
- Te lidhe marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortakët.
- Te zbatoje rregullat e brendeshme te shoqerise.
- Te shperbleje demet qe i vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mos veprimeve te tij.
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marreveshjes se bere midis tij dhe ortakëve.
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithcka qe ai e quan te dobishme per shoqerine.
- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre dhe ti paraqese ato, sipas rastit, per miratimin perfundimtar nga ortakët.
- Te behen prozimet perkatese ortakut te vetem kur lind nevoja per ndryshime ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- Te miratoje aktet normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin e personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise dhe te krijojne organe te tjera te domozdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Ti propozoje ortakëve per krijimin e njesive, strukturave te ndryshme si filial, dege e perfagesi ne qytetet te tjera te vendit ose jashte shtetit.
- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqese ortakut per miratim. Te perzgjedhe ekspertin kontabel dhe anetare te komisionit te likuidimit si dhe te paraqese propozimet per miratim para ortakëve .



- Te siguroje zbatimin e perpikte te Vendimeve te Ortakeve.
- Te kryeje cdo detyre tjeter qe i ngakohet nga ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 17

EKSPERTI KONTABEL

17.1 Shoqeria cakton ekspert kontabel per cdo viti financiar. Caktimi i tyre e ben administratori.

17.2 Eksperti kontabel mban pergjegjesi per mimbajtjen e rregullt te te gjithë dokumentacionit te shoqerise.

17.3 Ato pergjigjen per demet qe i vijne shoqerise nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

17.4 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi .

17.5 Nuk mund te ngarkohen me detyren e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat qe jane ne gjini e krushqi deri ne shkallen e katert. Po ashtu nuk mund te kryeje kete detyre pergjegjesat e zyrave, filialeve e agjensive.

KREU III

MARDHENIET E PUNES

NENI 18

Mardheniet e punes ne shoqeri, rregullohen nepermjet kontratave te punes. Per ceshtjet qe kjo kontrate nuk i parashikon zbatohen dispozitata perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 19

Per cdo mos marveshje qe mund te lindin midis paleve dhe qe nuk zgjidhet me mirkuptim apo consensus, organi kopetent per zgjidhjen e saj, eshte Gjykata e rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 20

Sekreti i punes

Te gjithë te punesuarit ne shoqeri, jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise. Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqeria.

KAPITULLI I IV

VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 21

Viti financiar

Vitit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Perjashtimisht viti i pare financiar, perfshin kohen nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.

NENI 22

Inventari dhe llogarite vjetore.

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

Ne mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurise, ne kete date dhe llogarite vjetore per vitin financiar .

NENI 23

Raportet vjetore

23.1 Ne mbylljen e cdo viti financiar administrtrori dhe eksperti kontabel, harton inventaret dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per ortaket.


23.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e rendesishme etj.

23.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar (nese eshte emruar) miratohen nga ortaket sipas Ligjit Nr 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 24.

Rezerva e domozdoshme dhe e nevojshme.

24.1 Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar, pasi zbriten humbet e vitit te meparshem, hiqet me nje ane nje shume e barabarte me 5 % (peseperqind) e fitimit, e desinuar per formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domozdoshme".



24.2 Heqja nga fitimi per rezerven e domosdoshme, pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye cfaredo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 10% e kapitalit.

24.3 Ortaket mund te vendosin edhe zbritje te vecante ne favor te rezervave te jashtezakoneshme ose per qellime te tjera, apo per shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

NENI 25

Te ardhurat eventualisht te ndjekura nga shoqeria cdo vit financiar jane te destinuar sic eshte vendosur nga ortaket duke i qendruar ne uljen 5 % qe do ti destinohet rezervave ligjore.

KAPITULLI V

MBLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 26

Veprimtaria e shoqerise mund te nderpritet para afatit kur shoqeria nuk rezulton rentable gjate dy vjeteve te fundit radhazi dhe kur per kete vendos gjykata kompetente.

NENI 27

27.1 Menjehere pas marrjes se vendimit per prishjen e shoqerise, ortaket caktojne nje likujditor, kopetencat e tij dhe menyren e likujdimit te shoqerise, me dispozitat perkatese te ligjit tregtar. Shoqeria gjate likujdimit mban anash emertimit dhe emrin "Shoqeri ne Likujdim e siper".

27.2 Likujditori i emruar nga ortaket, menjehere sapo merr detyren eshte i detyruar te publikoje bilancin e shoqerise, duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vene ne dispozicion menjehere ortakeve.

27.3 Me miratimin e likujdimit shoqeria i jep fund veprimtarise.

NENI 28

Ortaket vendosin mbi rregulishmerine e likujdimit, per te vendosur per bilancin e likujdimit dhe heqjen e mandatit te likujditorit.

Ortaket mund te vendosin vete realizimin e kesaj mbledhje, ne rast se likuidatori nuk e kerkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose te nje mandatmbajttesi te caktuar prej tij.

NENI 29

Kur ortaket per shkaqe te arsyeshme nuk vendosin per aktet e mesiperme, likujditori dhe cdo person i interesuar, mund te kerkoje nga Gjykata mbylljen e likujdimit.

DISPOZITET KALIMTARE

NENI 30

Dispozitat e fundit

30.1 Per te gjitha ceshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

30.2 Per efekt te inteprerimit te ketij Statuti me Ligj Tregtar nenkuptohet Ligji nr 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare".

30.3 Pavlefshmeria eventuale te dispozitave te vecanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine e tij.

NENI 31

Gjykata kopetente.

Gjykata kopetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarveshjeve dhe inteprerimin e Statutit te Shoqerise eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tirane.

NENI 32

Hyrja ne fuqi

Ky Statut hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

ORTAKET

ERMAND BUJARI

LULZIM BUJARI

ERMAND BUJARI

LULZIM BUJARI

